

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “UJËSJELLËS- KANALIZIME” SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE
S A R A N D Ë

V E N D I M
I ASAMBLESË SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS- KANALIZIME SH.A SARANDË
Nr.1,date 30.05.2016

Asambleja e përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë së “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Sarandë, e mbledhur sot, në datën 30/05/2016, me pjesëmarrjen e aksionereve të shoqërisë, Bashkia Sarandë, e përfaqësuar nga Kryetare znj. Florjana dhe Bashkia Finiq e përfaqësuar nga kryetari Z.Leonidha Hristo, paraqet për shqyrtim rendin e dites të caktuar “Miratimin e Statutit të Shoqërisë”, në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtar, i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , neni 64, pika f, V.K.M Nr.63 date 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”;

V E N D O S I

1.Miratimin e Statutit të Shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime sh.a Sarandë konform VKM Nr.63 date 27.01.2016..

2.Depozitimën e këtij vendimi pranë Q.K.R-së.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

BASHKIA SARANDE

Florjana Koka



BASHKIA FINIQ

Leonidha Hristo





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 1037 Date 19.12.2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
" UJESJELLES - KANALIZIME" SARANDE SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise " Ujesjelles - Kanalizime " Sarandë, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 63.3 % nga Bashkia Sarande, 10.1 % nga Komuna Dhiver, 13.8 % nga Komuna Aliko, 9.9 % nga Komuna Mesopotam dhe 2.9 % nga Komuna Finiq, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore".

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

